




REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUČITRN
01 Nr. / Br.	189/15
Nr. i fq. / Br. st	- 7 -
Date: / Datum	29. 09. 2015
VUSHTRRI - VUČITRN	



REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS VUSHTRRI

Në bazë të nenit 12, al.2, pika c, nenit 17, pika f, nenit 40 al.2, pika a dhe g, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, nenit 8 pika a, nenit 15 pika f, dhe nenit 19 al.1, të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal, nenit 15 al. 1, pika 8, të Ligjit për Mbeturina, dhe nenit 41. 2 shkronja (c) të Statutit të Komunës Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më **29 shtator 2015**, miratoi këtë:

**RREGULLORE
PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE NË KOMUNËN VUSHTRRISË**

Shtator 2015

Neni 1

Qëllimi

Kjo rregullore ka për qëllim që të rregulloj çështjen e menaxhimit të mbeturinave komunale, lartësinë e tarifës për MM, me qëllim që të krijohet një sistem i qëndrueshëm, për administrimin financiar mbi menaxhimin e mbeturinave.

Neni 2

Fushëveprimi

Kjo rregullore përcakton formën e minimizimit të mbeturinave, ndarjen, ruajtjen, shkarkimin, grumbullimin, transportimin, aktivitetet e riciklimit dhe taksën për mbeturina me qëllim të ruajtjes së mjedisit jetësor brenda territorit të Komunës së Vushtrrisë.

Neni 3

Përkufizimet

MM – Menaxhimi i Mbeturinave

Gjenerues i Mbeturinave -përfshin çdo subjekt, fizik ose juridik, i cili gjeneron ose zoteron mbeturina.

Mbeturina - substancë apo objekt që prodhuesi apo zotëruesi e hedhë, ka për qëllim ta hedhë apo është i detyruar ta hedhë.

Mbeturina Komunale – mbeturinat e krijuara nga amvisëritë dhe mbeturina tjera të shkaktuara nga aktivitete tjera të cilat për shkak të natyrës dhe përbërjes së tyre janë të ngjashme me ato të amvisërisë.

Qendër grumbulluese- sipërfaqe tokësore e caktuar nga Komuna për trajtimin e mbeturinave.

Person- peroni fizik ose juridik i cili është i involvuar në mënyrë të drejtpërdrejt apo tërthorazi në proceset për menaxhimin e mbeturinave.

Vend deponim- kuptojmë vendin për shkatërrimin apo asgjësimin e mbeturinave të rrezikshme ku hedhen, ngjeshën dhe mbulohen mbeturinat, konform dispozitave të ligjit përkatës.

Kompostimi- trajtimi i mbeturinave të biodegradueshme nën veprimin e mikroorganizmave në prezencën e oksigenit i cili kryhet me qëllim të prodhimit të kompostit nën kushtet e kontrolluara.

Largimi publik i mbeturinave- nënkupton procesin e mbledhjes, grumbullimit dhe transportit të mbeturinave.

Dorëzimi i mbeturinave- është nxjerra dhe hedha e mbeturinave nga gjeneruesi në vendin e caktuar të mbledhjes së mbeturinave.

Deponi - vend i caktuar dhe i irregulluar për mbeturina ku do të vendosen mbeturinat nën apo mbi sipërfaqe të tokës.

Mbeturina inerte- mbeturinat të cilat nuk pësojnë ndonjë ndryshim të rëndësishëm fizik, kimik apo biologjik në vendet ku janë deponuar.

3R – (është reduktimi, riciklimi dhe ripërdorimi i mbeturinave).

Neni 4

Mbledhja, grumbullimi dhe transportimi i mbeturinave

1. Grumbullimin dhe transportimin e mbeturinave e bënë personi juridik i licencuar dhe i kontraktuar nga komuna, i cili mbledhë grumbullon dhe transporton mbeturinat prej gjeneruesit e deri në deponinë e mbeturinave.
2. Mbeturinat e rrezikshme, paraprakisht klasifikohen sipas llojeve, mblidhen, grumbullohen dhe transportohen.
3. Nëse ndotja ndodh gjatë transportimit të mbeturinave, transportuesi është i detyruar që vendin e ndotur ta kthej në gjendje të mëparshme.

Neni 5

Përgjegjësitë e komunës për menaxhimin e mbeturinave

Përgjegjësitë e komunës për menaxhimin e mbeturinave janë:

1. Krijimi i një sistemi të qëndrueshëm mbi menaxhimin e mbeturinave komunale.
2. Krijimi i një sistemi të qëndrueshëm financiar për menaxhimin e mbeturinave.
3. Krijimi i procesit të kontraktimit për shërbimet e grumbullimit të mbeturinave.
4. Formimi i sektorit për menaxhimin e mbeturinave, në kuadër të Drejtorisë për Shërbime Publike:
 - 4.1 Sektori për menaxhimin e mbeturinave, monitoron dhe udhëzon ofruesit e shërbimeve për grumbullimin, transportimin dhe deponimin e mbeturinave,
 - 4.2 Të bëjë monitorimin mjedisor të qendrës së paketimit të mbeturinave të riciklueshme, e cila është duke u ndërtuar në fsh. Bukosh.
 - 4.3 Të identifikoj pikat ilegale (të zeza) të hedhes së mbeturinave dhe evitimi i tyre.
 - 4.4 Promovimi për minimizimin e mbeturinave (3R, kompostimit shtëpiak etj).
 - 4.5 Promovimi i ngritjes së vetëdijesimit publik, pjesëmarrja aktive e qytetarëve në implementimin e MM.
 - 4.6 Planifikimin buxhetor mbi funksionimin e menaxhimit mbeturinave.
 - 4.7 Faturimi i tarifës për mbeturinat, organizimi dhe shpërndarja.
 - 4.8 Përpilimi i raporteve për menaxhimin e mbeturinave, dhe shkallën e inkasimit të tarifës për mbeturinat.
5. Formimi i komisionit në kuadër të administratës komunale, për shqyrtimin e ankesave dhe parashtresave të taksapaguesve për mbeturina.
6. Caktimi i tarifës nga Kuvendi i Komunës për inkasim të mjeteve financiare për shërbimin e mbledhjes së mbeturinave.
7. Dorëzimi i raportit në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, për menaxhimin e mbeturinave çdo 31 mars të vitit paraprak.

8. Ka përgjegjësi që të sigurojë kushte veprimi dhe operimi për operatorët publik dhe privat.

Neni 6

Të drejtat dhe detyrat e gjeneruesve të mbeturinave

1. Çdo gjenerues i mbeturinave ka të drejtë qasjeje në shërbimin e grumbullimit të mbeturinave,
2. Çdo gjenerues i mbeturinave ka të drejtë ankese, ndaj shërbimit të ofruar.
3. Çdo gjenerues i mbeturinave duhet të respektoj rregullat e shkarkimit të përcaktuar sipas planit të menaxhimit të mbeturinave që do të hartohet nga Drejtoria për Shërbime Publike.
4. Çdo gjenerues duhet të bëjë përpjekje për minimizimin e mbeturinave (përmes kompostimit shtëpiak dhe formave tjera të mundshme).
5. Për shërbimin e ofruar, gjeneruesi obligohet të paguaj tarifën e shërbimit.
6. Çdo gjenerues, duhet të bashkëpunoj me autoritetin publik, për të siguruar një mjeshtëri pastër.
7. Ndërmarrjet prodhuese, shërbyese-hoteliere të cilat gjenerojnë mbeturina, obligohen që Komunës së Vushtrrisë t'ia dorëzojë planin e menaxhimit të mbeturinave, të cilat i gjenerojnë gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

Neni 7

Tarifa mbi mbeturinat

1. Tarifa për mbeturinat, nga viti 2016, do të faturohet dhe inkasohet nga komuna.
2. Faturimi i tarifës së mbeturinave bëhet në baza mujore, kurse fatura dorëzohet deri me 5 të secilit muaj vijues.
3. Gjeneruesi i mbeturinave në bazë të kërkesës së tij mund të paguaj faturën e tarifës së mbeturinave për një muaj, në katër këste apo për tërë vitin:
4. Pagesa e tarifës për mbeturinat në shumën deri në 10 € bëhet në arkën e komunës, kurse në shumën mbi 10 € bëhet në cilëndo bankë ose në sportelet e Postës së Kosovës.
5. Nëse gjeneruesi i mbeturinave nuk i paguan 2 këste të njëpasnjëshme, ndaj tij do të ndërmerren masat ndëshkuuese ligjore, si dhe i njëjti nuk do të merr shërbime komunale administrative për:
 - 5.1. Shërbimet nga Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër.
 - 5.2. Shërbime nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.
 - 5.3. Shërbimet nga Drejtoria për Shërbime Publike
 - 5.4. Shërbimet nga Drejtoria e Prokurimit.
 - 5.5. Shërbimet nga Drejtoria për Zhvillim Ekonomik Bujqësi dhe Pylltari.

5.6. Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

6. Tarifa mujore për mbeturina kategorizohet sipas shtojcës nr. 1 tarifat për mbeturina:

6.1. Shkalla e tarifës do të rishikohet çdo shtator nga Drejtoria për Shërbime Publike, duke marr parasysh performancën e shkallës së inkasimit dhe rr Ethanat tjera që ndërlidhen me menaxhimin e mbeturinave. Kuvendi i Komunës aprovon shkallën e përshtatshme të propozuar për vitin vijues, për të cilën njoftohen qytetarët para vitit të ardhshëm fiskal.

6.2. Tarifa fillestare për mbeturina është e adaptuar sipas tarifës për mbeturina që është përdorur në vitin 2015, siç është bashkangjitur në shtojcën 1 (shkalla e tarifës për mbeturina).

6.3. Tarifa minimale e shërbimit të grumbullimit të mbeturinave u ofrohet institucioneve dhe bizneseve të mëdha që të kontraktojnë shërbimin individualisht siç edhe është përcaktuar, për të ruajtur kualitetin e shërbimit të grumbullimit të mbeturinave.

Neni 8

Detyrat dhe përgjegjësitë e operatorëve të kontraktuar për shërbimin e mbeturinave

Operatori i kontraktuar nga organi kontraktues, për ofrimin e shërbimeve për menaxhimin e mbeturinave, është i obliguar që të veproj sipas kontratës dhe ligjeve në fuqi.

Neni 9

Detyrat e inspektorëve komunal

Inspektori mjedisor komunal ,inspektori i higjenës komunale si dhe inspektorët tjerë për çështje komunale mbikëqyrin dhe inspektojnë menaxhimin e mbeturinave në objektet, pajisjet dhe hapësirat të cilat gjenden në territorin e Komunës së Vushtrrisë, duke ndërmarrë masa për mbrojtjen e mjedisit të përcaktuara sipas dispozitave të ligjeve në fuqi.

Neni 10

Komisioni këshillues

1. Komisioni këshillues themelohet nën sektorin e menaxhimit të mbeturinave, Drejtoria për Shërbime Publike, i cili monitoron performancën e shërbimit të grumbullimit të mbeturinave nga operatorët e kontraktuar. Ky monitorim do të ndihmonte Komunën e Vushtrrisë, e cila ka burime njerëzore të kufizuara dhe në të njëjtën kohë do të promovonte sistemin pjesëmarrës të menaxhimit të mbeturinave.

2. Komisioni këshillues

2.1 Komisioni këshillues përbëhet nga më së shumti 5 anëtar.

2.2 Sektori i menaxhimit të mbeturinave i rekomandon anëtarët nga kriteret e mëposhtme dhe kryetari i miraton.

- 2.2.1. Përfaqësues komuniteti
- 2.2.2. Ekspertë nga fusha përkatëse
- 2.2.3. Përfaqësues nga etnititet relevant
- 2.2.4. Qytetarë të zgjedhur mes aplikantëve dy persona

3. Detyrat e komisionit këshillues janë:

- Të monitoroj shërbimin e grumbullimit të mbeturinave që ofrohet nga operatorët e kontraktuar
- Të përmbledh opinionet e qytetarëve sa i përket kualitetit të shërbimit të grumbullimit të mbeturinave
- Të raportoj për rezultatet e monitorimit dhe opinionet e qytetarëve në takimet e komisionit këshillues të cilat duhet të mbahen konform me nenin 9.3.

4. Mandati i anëtarëve të komisionit këshillues është dy vjeçar. Në rast të krijimit të vendit të lirë, mandati i zëvendësuesit do të ketë vlefshmërinë deri në kohën e mbetur të përfundimit të mandatit të anëtarit paraprak.

5. Anëtari mund të ri-zgjidhet.

6. Pagesa / Mëditja e anëtarit caktohet me vendim nga Kuvendi i Komunës.

7. Komisioni këshillues duhet të mbajë takime së paku njëherë në tre muaj, përmbledh gjendjen e shërbimit të grumbullimit të mbeturinave dhe e dorëzon raportin (raport 3 mujor) te Sektori për Menaxhimin e Mbeturinave.

8. Sekretaria e komisionit këshillues është brenda Sektorit të Menaxhimit të Mbeturinave dhe sektori kryen punët administrative.

Neni 11

Dispozitat ndëshkuese - Gjobat

1. Gjeneruesit që nuk i përbahet afateve të pagesës së faturave sipas kësaj rregulloreje, ngarkohen me pagimin e borxhit me kamatë ndëshkuese.
2. Ndaj gjeneruesit të mbeturinave i cili nuk e bënë pagesën e tarifës për mbeturina brenda 15 ditëve, do të iniciohet procedurë gjyqësore në gjykaten kompetente.
3. Ndaj gjeneruesit të mbeturinave i cili nuk i përbahet rregullave të shkarkimit, të përcaktuara sipas planit të menaxhimit të mbeturinave, do të zbatohen dispozitat e legjislacionit në fuqi.

Neni 12

Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare

1. Në të gjitha rastet që nuk janë të rregulluara me këtë rregullore, do të zbatohen dispozitat e Ligjeve në Fuqi,
2. Për zbatimin e kësaj rregulloreje kujdesen: kryetari i komunës, Drejtoria për Shërbime Publike , Drejtoria për Inspektime dhe njësit përkatëse të administratës komunale.
3. Kjo rregullore hyn në fuqi tetë (8) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë dhe do të zbatohet nga viti 2016.

Shtojca 1: Tarifa mujore e tarifës për mbeturina;

1 Amvisëritë:

a) Zona Urbane----- 4.40 €

b) Zona Rurale ----- 4.40 €

2 Tarifa e tarifës së mbeturinave për biznese dhe lokale tjera afariste do të caktohet në bazë të hapësirës së objektit në m², dhe atë si më poshtë:

a) Lokalet biznesore me hapësirë prej 01-20 m²- 5.30 €

b) Lokalet biznesore me hapësirë prej 21-50 m² - 11.70 €

c) Lokalet biznesore me hapësirë prej mbi 50 m² - 23.50 €

4. Tarifa minimale për Institucionet publike dhe bizneset e shkallës më të lartë bëhen me kontraktim individual me kontraktuesin e shërbimit.

a) Kostoja e kontejnerit 1.1 m³ ----- 11.50 euro/ zbrazje

b) Kostoja e kontejnerit 7 m³ ----- 50.68 euro/zbrazje

Kryesuesi i Kuvendit

Shpëtim Zhegrova